



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2699/ prot.

Elbasan, me 28.10.2024

VENDIM

Nr. 50 datë 28.10.2024

Për

miratimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të studentëve “Për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit” dhe ngritjen e Komisionit “Ad Hoc”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit,” i ndryshuar, lidhur me procesin e shqyrtimit e miratimin të rasteve për studentët e shkëlqyer, studentët me rezultate dhe studentët, që plotësojnë kriteret e tjera për përfitim burse, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- A. Miratimin e procedurave për kërkesat e studentëve “Për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit”

I. Studentët e shkëlqyer dhe me rezultate (mesatare 9.00-10.00)

1. Studentët e shkëlqyer me notë mesatare 10-të në një program të parë studimi, që ndjekin një program të dytë studimi të përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit në programet e studimit me karakter profesional, programet bachelor, programet e integruara. Ky kriter vlen edhe për studentët e vitit të dytë e të tretë që mesataren e vitit



paraardhës e kanë 10-të por që janë studentë të shkëlqyer me notë mesatare 10-të në një program të parë studimi.

2. Studentët me rezultate (mesatare 9.00 deri 10.00) të përfshihen në procedurën për përfitimin e bursës financiare dhe përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit. Sekretaritetë mësimore të fakultetit përkatës, llogarisin notën mesatare të ponderuar, për studentët që ndjekin studimet në vitin e dytë e të tretë në bazë të rezultateve të vitit paraardhës, pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për këtë vit. Studentët që fillojnë vitin e parë në vitin akademik 2024-2025 mesataja e shkollës së mesme ju vjen e llogaritur nga QSHA.

II. Studentë me kritere të tjera

1. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike.
2. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë në institucionet e arsimit të lartë publik.
3. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Student, person me aftësi të kufizuara.
4. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Student, i cili i ka të dy prindërit me aftësi të kufizuara
5. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Student, me prind bashkëjetues pensionist dhe prindi tjetër i është ndarë nga jeta.
6. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Student, i cili i ka të dy prindërit pensionistë.
7. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Student, i cili është i treti e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë.
8. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.
9. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç.
10. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore deri në moshën 25 vjeç.
11. Të përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
12. Të përfitojnë vetëm përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Student, i cili ka njërin nga prindërit me aftësi të kufizuara
13. Të përfitojnë vetëm përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Studentët romë dhe egjiptianë.
14. Të përfitojnë vetëm përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.



III. Studentët e programeve të studimit me karakter profesional, programeve bachelor, programeve të integruara të studimeve e humbasin të drejtën e përfitimit të bursës financiare apo përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit:

Nuk përfitojnë bursë financiare.

1. Studentët që vazhdojnë studimet në **program të dytë studimi** (studentët që studiojnë për diplomë të dytë ose kanë mbaruar një shkollë të lartë)
2. Studentët që janë në gjendje civile **të ndarë nga trangu familjar.**
3. Studentët që **janë përsëritës** (humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue)
4. Studentët që **nuk janë në vitin normal të studimit** (Nuk janë brenda kohëzgjatjes normale të studimit sipas përcaktimeve në aktet normative pra nëse studenti gjatë kohës së studimeve ka qenë përsëritës, në vitin pasardhës nuk fiton bursë)

Nuk përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit.

1. Studentët që vazhdojnë studimet në **program të dytë studimi** (studentët që studiojnë për diplomë të dytë ose kanë mbaruar një shkollë të lartë)
2. Studentët që janë në gjendje civile **të ndarë nga trangu familjar,**
3. Studentët që **janë përsëritës** (humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue)

Kërkesat për përfitim burse financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025, i paraqesin studentët, që vazhdojnë studimet **në program të parë studimi në;** programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit në plotësim të kriterëve të përcaktuara në VKM-t e cituara më lart për studentët në nevojë. Ky proces është gjatë tërë vitit akademik (deri më 31 maj 2025) nga momenti i plotësimit të kriterit. Sipas VKM-ve të mësipërme studentët për program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara, që aplikojnë deri më **24 dhjetor 2024 e përfitojnë bursën financiare nga data e fillimit të vitit akademik ose nga data e regjistrimit për vitin e parë, ndërsa studentët që aplikojnë pas datës 24 dhjetor 2024, e përfitojnë bursën financiare duke filluar nga muaji pasardhës, ndërsa tarifën vjetore të shkollimit e përfitojnë në momentin e aplikimit nëse plotëson kriteret.**

1. Më datë **01.11.2024** të fillojë procedura e aplikimit e plotësimit të kriterëve përkatëse për përfitim burse dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit sipas VKM-ve të mësipërme. Studentët, do të gjejnë të ngarkuar në: eei@uniel.edu.al, Rubrika/ Zona e studentit/ njoftime, formularin **“DEKLARIM (KËRKESË) PËR PËRFITIM BURSE DHE/OSE PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025”**
2. Studentët në programet e studimit me karakter profesional, programet bachelor, programet e integruara, të interesuar për përfitim burse financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025, do të plotësojnë kërkesën, sipas formatit të përcaktuar si dhe do të bashkëlidhin dokumenta të skanuara për kriteret që kërkojnë dokumenta specifike. Aplikimi i plotësuar sipas formularit (në ËORD) do të dërgojnë në formë shkresore në portokoll me adresë: **Zyra e Këshillimit karrierës dhe ALUMNI/ Korpusi kryesor/ Kati i dytë.**
3. Për çdo sqarim të nevojshëm për përfitim burse dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit studentët do të kenë specialistë: **Zyra e Këshillimit karrierës dhe ALUMNI/ Korpusi kryesor/ Kati i dytë**
4. Kërkesa e dorëzuar nga studenti, pas portokollimit do të përpunohet nga Komisioni “Ad Hoc”

5. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës së studentit, të kryhet verifikimi i nevojshëm për plotësimin e kriterëve të deklaruara, në bashkëpunim me institucionet që kanë detyrimin ligjor për të konfirmuar kriterin e përfitimit të studentit (familjes së tij).
 6. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga studenti në portokoll, Bordi i Administrimit shqyrton dhe merr vendim për përfitimin ose jo të bursës dhe përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që përmbushin kriteret sipas VKM-ve të mësipërme.
- B. Ngritjen e Komisionit “Ad Hoc” për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve të shkëlqyer, studentët me rezultate (me notë mesatare të ponderuar 9.00-10.00) dhe kërkesave të studentëve me kriterë të tjera, për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve për program të parë në; programet e studimit me karakter profesional, programet e studimit bachelor, programet e integruara të studimit me përbërje si më poshtë:
1. Filip Qosja – kryetar (menaxhimin e komisionit për realizimin e procedurave, përgatitjen e materialeve për Administratorin dhe relatimin e këtij materiali në Bordin e Administrimit)
 2. Eglantina Palloshi – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
 3. Romina Pitja – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
 4. Enea Qevani – anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime të ankesave të studentit)
 5. Laureta Bajrami – anëtare (Përgatitja e kërkesës për përpunim, nxjerrja e certifikatave familjare e-Albania, hartimi i inventarit të dosjes së studentit)
 6. Daniela Karalliu – anëtare (Përgatitja e kërkesës për përpunim, nxjerrja e certifikatave familjare e-Albania, hartimi i inventarit të dosjes së studentit)
 7. Fejzie Musta – anëtare (Procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave)
 8. Arta Skënderi – anëtare (përgatitjen e listave për verifikim në institucione, procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave)
 9. Rovenja Myftaraj – anëtare (përgatitjen e listave për verifikim në institucione, procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistemin e pagesave, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
 10. Armida Gjata – anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem, komunikimi me studentët për procedurat financiare)
 11. Etleva Sejdini – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FSHMT)
 12. Blerina Hyra – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FSHMT)
 13. Elsona Shevroja – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FSHN)
 14. Blegina Muça – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FSHH)
 15. Majlinda Daiu – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FSHE)
 16. Erjola Piligrui – anëtare (procedura për llogaritjen e mesatareve për çdo program studimi FE)
 17. Besa Kozarja – anëtare (procedura e pritjes së kërkesave të studentëve dhe këshillimi i studentëve në përgatitjen e dokumentacionit të kërkesës)
 18. Marsela Balla – anëtare (procedura e pritjes së kërkesave të studentëve dhe protokollimi i tyre)

- C. Komisioni të realizojë pranimin e kërkesës së studentit, të kryejë verifikimin e nevojshëm në zbatim të akteve të mësipërme për këto procedura.
- D. Për studentët e shkëlqyer dhe studentët me rezultate, të merren të dhënat nga Fakultetet e UE-së dhe të bëhet përpunimi i tyre.
- E. Për studentët që paraqesin kërkesën me kritere tjera, të merren të dhënat nga Fakultetet e UE-së për statusin aktual të studimit (studentë me kohëzgjatje normale) dhe të bëhet përpunimi i tyre
- F. Materiali i përgatitur nga komisioni të paraqitet nga Administratori i UE-së në Bordin e Administrimit për shqyrtim e miratim rast pas rasti në zbatim të afateve të përcaktuara në VKM-t përkatëse.
- G. Vendimet e Bordit të Administrimit do të bëhen publike në ambientet e Rektoratit dhe faqen zyrtare të UE-së.
- H. Vendimet e Bordit të Administrimit mund të ankimohen brenda 24 orëve nga publikimi i vendimeve.
- I. Ankesat lidhur me vendimin e Bordit të Administrimit do të shqyrtohen paraprakisht nga Komisioni i mësipërm dhe përcillen për vendimmarrje Bordit të Administrimit, brenda ditës së nesërme.
- J. Ngarkohet Administratori dhe Komisioni i mësipërm me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Dr. Ardian Durmishi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

**DEKLARIM (KËRKESË) PËR PËRFITIM BURSE DHE/OSE PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

(Për studentët në programet e studimit me karakter profesional, programet bachelor, programet e integruara, program i parë studimi)

Datë ____ . ____ . ____

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË STUDENTIT KËRKUES

(Plotëso të dhënat e domosdoshme në pozicionin e vijëzuar për kriterin që i përkasin dhe dorëzo: **kërkesën e plotësuar, certifikatën familjare të shkarkuar nga e-Albania, Kartë identiteti / pasaporte - fotokopje**)

Dokumentacioni të dërgohet në adresën:

Zyra e Këshillimit Karrierës dhe ALUMNI/ Korpusi kryesor/ Kati i dytë.

Emër , Atësi, Mbiemër	_____	Datëlindja	____/____/____
Numri identifikimit personal i studentit ID:	_____ (Kartë identiteti / pasaporte)		
Fakulteti	FSHN _____, FSHMT _____	FSHH _____	FE _____ FSHE _____
Viti i studimit	____, _____, _____		
Programi i studimit - Dega	_____		

“KËRKESË PËR PËRFITIM BURSE DHE PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT”

Unë kërkesuesi paraqes kërkesën time, pasi i përkas një prej kategorive të përcaktuara nga kriteri 1 deri tek kriteri 11.

(Nëse kërkesa dorëzohet deri me datë 24.12.2024 bursa përfitohet nga data e fillimit të vitit akademik e në vijim, ndërsa kërkesa e dorëzuar pas datës 24.12.2024 bursa përfitohet nga muaji pasardhës e në vijim.)

Kriteri 1	Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike
☐	Deklarim për trajtimin e familjes me ndihmë ekonomike, ku të theksohet Emër Atësi Mbiemër i k/familjarit përfitues dhe adresa e saktë e Njesisë administrative ku përfitohet ndihma ekonomike : _____
Kriteri 2	Studentët bashkëshortë, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë
☐	Deklarim për studimet që ndjek secili bashkëshort në institucionet e arsimit të lartë (Programi i studimit, institucioni i arsimit të lartë): _____
Kriteri 3	Student me aftësi të kufizuara.
☐	Deklarim për trajtim me Aftësi të kufizuara, (nga KMCAP-së) ku të theksohet Emër Atësi Mbiemër i përfituesit të aftësisë së kufizuar dhe adresa e saktë e Njesisë administrative/ Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) ku përfitohet pagesa e aftësisë së kufizuar; _____
Kriteri 4	Student, i cili i ka të dy prindërit me aftësi të kufizuara
☐	Deklarim për trajtim me Aftësi të kufizuara, (nga KMCAP-së) për secilin prind, ku të theksohet Emër Atësi Mbiemër i secilit përfitues të aftësisë së kufizuar dhe adresa e saktë e Njesisë administrative/ Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) ku përfitohet pagesa e aftësisë së kufizuar; _____
Kriteri 5	Student, me prind bashkëjetues pensionist dhe prindi tjetër i është ndarë nga jeta
☐	Deklarim që prindi bashkëjetues trajtohet me pension pleqërie nga DRSSH përkatëse dhe Certifikatë vdekjeje e prindit që është ndarë nga jeta; _____ (Bashkëlidhur Certifikatë vdekjeje e prindit që është ndarë nga jeta)
Kriteri 6	Student, i cili i ka të dy prindërit pensionistë
☐	Deklarim që prindërit bashkëjetues trajtohen me pension pleqërie nga DRSSH përkatëse; _____
Kriteri 7	Student, i cili është i treti e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë
☐	Deklarim për secilin nga dy fëmijët e parë të familjes që janë studentë (për secilin student Programi i studimit, institucioni i arsimit të lartë); _____
Kriteri 8	Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.

☐	Deklarim nga studenti që ka përfitur statusit e jetimit: _____ (Bashkëlidhur librezë për përfitim të statusit të jetimit lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose certifikatë vdekjeje e secilit prind që është ndarë nga jeta, dokument që vërteton se janë të lindur jashtë martese, Vendim i gjykatës ku është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton, dokument që vërteton që janë braktisur nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre)
Kriteri 9	Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç.
☐	Deklarim nga studenti që ka humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë _____ (Bashkëlidhur, vendimi i formës së prerë të gjykatës për humbjen e kujdestarisë prindërore)
Kriteri 10	Studentët që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfitur statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore deri në moshën 25 vjeç.
☐	Deklarim nga studenti që janë viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfitur statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore _____ (Bashkëlidhur dokument origjinal që vërteton se kanë përfitur statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror)
Kriteri 11	Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
☐	Deklarim nga studenti që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës: _____ (Bashkëlidhur, dokument origjinal lëshuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajo e mbrojtjes)
“KËRKESË VETËM PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT” Unë kërkesuesi paraqes kërkesën time, pasi i përkas një prej kategorive të përcaktuara nga kriteri 12 deri tek kriteri 14.	
Kriteri 12	Student, i cili ka njërin nga prindërit me aftësi të kufizuara
☐	Deklarim për trajtim me Aftësi të kufizuara, (nga KMCAP-së) për prindin përfitues, ku të theksohet Emër Atësia Mbiemri i secilit përfitues të aftësisë së kufizuar dhe adresa e saktë e Njësisë administrative/Dega sigurimeve shoqërore ku përfitohet pagesa e aftësisë së kufizuar; _____
Kriteri 13	Studentët romë dhe egjiptianë.
☐	Deklarim nga studenti që i përket komunitetit romë dhe egjiptianë _____ (Bashkëlidhur, deklaratë noteriale e studentit, ku vetë deklarohet se i përket komunitetit romë dhe egjiptianë)
Kriteri 14	Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.
☐	Deklarim nga studenti që është fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist, ose që vërteton se prindi i studentit ka statusin e të dënuarit politik me heqje lirie; _____ (Bashkëlidhur vërtetim origjinal, që vërteton se studenti ka statusin “Fëmijë i ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politik nga sistemi komunist” ose “Prindi i studentit ka statusin e të dënuarit politik me heqje lirie”)
Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i/e vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Autorizoj Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit tim si dhe publikimin e tyre	
KËRKUESI Emri mbiemri _____ Adresa email: _____, Cel _____ Raifeisen Bank llogaria nr. _____	

